



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2023:217703  
Datë: 24.04.2024  
Numri i dokumentit: 05611316

**K.Dh.Shk.II.nr.411/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin individual Ramush Bardiqi, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Enercogas” ShPK, me NUI: 811253864, me seli në fshatin Llabjan, në Pejë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Artan Kastrati, avokat nga Peja, kundër debitorit “Mamas Hood” ShPK me NUI:811847261, me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1665/23 të datës 29.11.2023, me datë 23.04.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e bazuar ankesa e kreditorit “Enercogas” ShPK, me seli në fshatin Llabjan, në Pejë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1655/23 i datës 29.11.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1655/23 të datës 29.11.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “Mamas Hood” ShPK dhe ka shfuqizuar urdhërin përmbarimor P.nr.238/23 të datës 13.09.2023 të Përmbaruesit Privat Jeton Krasniqi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori “Enercogas” ShPK, me seli në fshatin Llabjan, për shkak të vërtetimit të shkeljes thelbësore të dispozitave të LPK-së në kuptim të nenit 182 par.182.1 të LPK-së, aplikimit të gabuar të nenit 29 par.3, lidhur me nenin 71 par.1 nën par.1.1 të LPP-së dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe provave konform nenit 183 të LPK-së, duke propozuar që aprovohet si e bazuar ankesa e Kreditorit “Enercogas” ShPK, me numër unik identifikues të biznesit 811253864 dhe prishet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1655/23 i datës 29.11.2023, dhe refuzohet si i pabazuar prapësimi

Përgjigje në ankesa ka parashtruar debitori, me të cilën ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e kreditorit.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Enercogas” ShPK, me seli në fshatin Llabjan, me datën 11.09.2023 ka paraqitur propozim për lejimin e përmbartimit, kundër debitorit “Mamas Hood” ShPK me seli në Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës Nr.1240 të datës 05.04.2023; Faturës Nr. 1074 të datës 23.03.2023; Faturës Nr. 976 të datës 16.03.2023; Faturës Nr. 887 të datës 09.03.2023; Faturës Nr. 802 të datës 02.03.2023; Faturës Nr. 650 të datës 20.02.2023; Faturës Nr. 415 të datës 03.02.2023; Faturës Nr. 488 të datës 09.02.2023; Faturës Nr. 286 të datës 26.01.2023; Faturës Nr. 206 të datës 19.01.2023; Faturës Nr. 118 të datës 11.01.2023; Faturës Nr. 54 të datës 06.01.2023; Faturës Nr. 81539 të datës 22.12.2022; Faturës Nr. 81447 të datës 15.12.2022; Faturës Nr. 81355 të datës 08.12.2022; Faturës Nr. 81150 të datës 24.11.2022; Faturës Nr. 80913 të datës 04.11.2022; Faturës Nr. 80747 të datës 26.10.2022; Faturës Nr. 1547; Faturës Nr. 1547 të datës 03.05.2023 dhe Faturës Nr. 1667 të datës 12.05.2022 me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që në afat prej 7 ditësh t’ ia paguaj kreditorit borxhin në shumën prej 2,299.50 €, me kamatëvonesë prej 8% në vit, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, me bllokimin e të gjitha llogarive bankare të debitorit, si dhe me inventarizimin dhe sekuestrimin e pasurisë së debitorit deri në përmbushjen e kërkesës së kreditorit.

Përmbartuesi Privat Jeton Krasniqi, me seli në Pejë, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin përmbartimor P.nr.365/23 të datës 11.09.2023, e ka lejuar përmbartimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori me datë 04.10.2023, ka ushtruar prapësim duke theksuar se dokumenti në bazë të cili është marr vendimi përmbartues ose urdhri përmbartimor nuk ka titull ekzekutiv dhe nuk ka tipare të përmbartushmërisë.

Gjykata Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1655/23 të datës 29.11.2023, me të cilin e ka aprovuar në tërësi prapësimin e debitorit “Mamas Hood” ShPK, kundër urdhrin për përmbartim P.nr.238/23 të datës 13.09.2023 të Përmbartuesit Privat Jeton Krasniqi.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar Gjykata duke u bazuar në faturat e lartcekura, në bazë të së cilave është mbështetur propozimi për përmbartim gjeti se, të njëjtat janë bashkëngjitur në kopje, ndërsa në shkresat e lëndës nuk është deponuar origjinali apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit, e rrjedhimisht propozimi për përmbartim është paraqitur në kundërshtim me nenin 38 par.1 të LPP-së i cili përcakton se “*Propozimi për përmbartim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbartim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbartimor origjinal apo kopje*

*e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm..” Sipas nenit 43, par.4 të LPP-së përcaktohet se: “Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbartueshmërisë së nxjerrë nga përmbartuesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbartimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbartuesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbartim nga përmbartuesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim” . Bazuar në dispozitën e sipërcituar, gjykata gjeti se në rastin konkret urdhri përmbartimor P.nr.238/23 i datës 13.09.2023, është nxjerrë pa plotësimin e kushteve për lejimin e përmbartimit, ngase propozimi për përmbartim bazohet në dokumente kopje dhe si i tillë përmban të meta në kuptim të nenit 38, paragrafi 1 të LPP-së, të cilat në këtë fazë të procedurës nuk mund të evitohen nga gjykata, ngase në fazën e mjetit juridik, gjykata kufizohet vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri si dhe ligjshmërinë e urdhrin.*

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore me rastin e vendosjes për aprovim të prapësimin të debitorit. Fillimisht propozimin për përmbartim është ushtruar në bazë të faturave të cilat nuk i përmban tiparet e faturave të rregullta, pasi që të njëjta nuk janë dorëzuar në origjinal dhe nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm në procedurë përmbartimore. Neni 38 par.1 të LPP-së i cili përcakton se “*Propozimi për përmbartim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbartim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbartimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm..”*

Mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, kjo Gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë se fatura si dokument i besueshëm mbi të cilën ishte iniciuar procedura përmbartimore, respektivisht është lejuar përmbartimi nuk i plotëson kushtet në mënyrë kumulative që duhet t’i ketë dokumenti i besueshëm. Në rastin konkret qartë rezulton se faturat nuk janë në origjinal ose në kopje të vërtetuar.

Gjykata Komerciale - Dhomat e shkallës së dytë duke shqyrtuar pretendimet ankimore të kreditorit, të njëjtat i vlerëson si të pabazuara dhe të pa qëndrueshme, kjo për faktin se edhe pse kreditori ka dorëzuar me ankesë faturat në origjinal, të njëjtat nuk janë të nënshkruara nga debitori, prandaj gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar se prapësimi nuk është i bazuar dhe nuk përmban asnjë nga shkaqet e përcaktuara me nenin 71 të LPP-së, ngase fatura në bazë të së cilës është lëshuar Urdhri Përmbartimor, nuk mund të trajtohet si dokument i besueshëm në kuptim të nenit 29 të LPP-së, si dhe përmban të gjitha të gjitha elementet e kërkuara nga dispozita e lartcekur.

Me nenin 29 par.1 pika 1.3 të LPP përcaktohet se “ 1. Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.3. faturat”. Ndërsa në paragrafin 3 të të njëjtit nen përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”. Po ashtu, me nenin 37 dhe 40 par.1 pika 3 i LPP-së, përcaktohet se propozimi për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm duhet të përmbajë “origjinalin apo kopjen e vërtetuar të dokumentit të besueshëm, ndërsa në rastin konkret edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate faturat e lartcekura nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se e njëjtat nuk janë në origjinal ose kopje të vërtetuar.

Duke u mbështetur ne nenin 69 par.4 te LPP “baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”, Gjykata vlerëson se ankesa e kreditorit është e pathemeltë pasi që kreditori nuk ka ofruar ndonjë provë për të vërtetuar pretendimet e veta, për vendosjen ndryshe.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të se drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË**  
**Dhoma e shkallës së dytë**  
**Kom.Dh.Shk.II.nr.411/24 dt. 23.04.2024**

**Gjyqtari,**  
**Ramush Bardiqi**